

**VENDIM**  
**Nr.909, datë 29.12.2004**

**PËR MËNYRËN DHE KRITERET E RIMBURSIMIT TË BARNAVE PËR  
USHTARAKËT E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr.9210. datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura (oficerë, nënoficerë, ushtarë me pagesë/profesionistë), ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv, oficerëve, që kanë dalë në rezervë dhe lirim, e vërtetuar kjo me dokumentin e “Identifikimit ushtarak”, iu rimbursohen në masën 80 për qind, për çdo alternativë, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, barnat e listës së rimbursimeve.
  2. Nëse për një grup barnash të caktuara ekziston një masë mbulimi më e madhe se 80 për qind, rimbursimi për kategoritë e parashikuara në pikën 1, të bëhet sipas listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, referuar alternativës së parë të barit.
  3. Ushtarakëve, që dëmtohen gjatë operacioneve ushtarake ndërkombëtare, iu rimbursohen barnat në masën 100 për qind, deri në riaftësimin e tyre, sipas vërtetimit të institucionit shëndetësor, që ka kryer trajtimin e ushtarakut.
  4. Ushtarakët, që dalin në lirim për shkak të dënimit me burg, për krime, me vendim gjykate të formës së prerë, nuk përfitojnë rimbursim barnash.
  5. Ministria e Mbrojtjes, nga buxheti i vet, derdh kontribute tek Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për mbulimin e diferencës ndërmjet masës së mbulimit të çmimit të barnave, të përcaktuar në këtë vendim dhe masës së mbulimit të çmimit të alternativave, sipas listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
  6. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, në zbatim të këtij vendimi, rimbursion farmacitë e tregtimit me pakicë të barnave, të cilat kanë kontratë me të, për diferencën e çmimit, të përcaktuar në pikën 5, për kategoritë e ushtarakëve përfitues, vetëm kur ata identifikohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe vërtetohet me dokumentin “Identifikimi ushtarak”, se u përkasin këtyre kategorive, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore.
  7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi që derdh, çdo vit, për këtë qëllim, Ministria e Mbrojtjes në buxhetin e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
  8. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga 1.11.2005.

**KRYEMINISTRI**  
**FATOS NANO**